


**STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"SaniService" Sh.p.k.**



- Investital Ll. ("**Investital**"), shoqëri e së drejtës kosovare, regjistruar pranë Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë, me kod fiskal 601138507, me seli në Bedri Shala, nr. 1, Prishtinë, Kosovë, me administrator te vetem Z. Ilir Rrapaj, qytetar shqiptar, lindur në Vlorë, Shqipëri, më 19.04.1972, me leter njoftim nr. 032169553 dhe numer personal H20419098N, perfaqesuar nga Z. Umbro Staccini, qytetar italian, lindur ne Perugia, me 07.04.1952, me banim ne Umbertide (PG), me pasaporte n. YA4124652, ne baze te prokures se posacme nr. 1824 rep. e nr. 525 kol. te leshuar me date 25.06.2015, para noerit Valbona Selimi;
- Servizi Italia S.p.A. ("**Servizi Italia**"), shoqëri e së drejtës italiane, regjistruar pranë Dhomës së Tregtisë Parmë, me numër regjistrimi dhe kod fiskal 08531760158, me seli në Soragna, (PR), Via San Pietro, 59 B Cap 43019, frazione Castellina, Itali, me Kryetar te Keshillit te Administrimit Z. Enea Righi, qytetar italian, lindur në Sala Bolognese (BO), më 19.02.1956, me kartë identiteti nr. AT 8549127, perfaqesuar nga Z. Umbro Staccini, qytetar italian, lindur ne Perugia, me 07.04.1952, me banim ne Umbertide (PG), me pasaporte n. YA4124652, ne baze te prokures se posacme nr. 1824 rep. e nr. 525 kol. te leshuar me date 25.06.2015, para noerit Valbona Selimi;
- Tecnosanimed S.r.l. ("**Tecnosanimed**"), shoqëri e së drejtës italiane, regjistruar pranë Dhomës së Tregtisë Peruxhia, me numër regjistrimi dhe kod fiskal 00660040544, me seli në Umbertide (PG), Via del Commercio, 2 Cap 06019, frazione Pierantonio Zona Industriale, Itali, përfaqësuar nga Z. Umbro Staccini, qytetar italian, lindur në Perugia, më 07.04.1952, me pasaportë nr. YA4124652, sipas vendimit të Këshillit Administrativ të shoqërisë, datë 14.02.2015 të shoqërisë; dhe
- U.Jet S.r.l. ("**Ujet**"), shoqëri e së drejtës italiane, regjistruar pranë Dhomës së Tregtisë Peruxhia, me numër regjistrimi dhe kod fiskal 01388750547, me seli në Bastia Umbra (PG), Via S. Francescuccio de' Mietitori, 32 Cap 06083, Itali, përfaqësuar nga Z. Giorgio Tardioli, qytetar italian, lindur ne Assisi (PG), me 22.05.1953, me letër njoftim nr. AS 9624240, ne baze te procesverbalit te Asamblesë se Përgjithshme te shoqërisë date 18.02.2015 rep. 260.237.

Palet e lartpermendura kane vendosur të nënshkruajë Statutin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky Statut.

**KAPITULLI I
FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**

Neni 1 – Forma

- 1.1. Shoqëria "SaniService" Sh.p.k. (në vijim "Shoqëria") krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti.
- 1.2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3. Statuti i shoqërisë është në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 – Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është "SaniService" Sh.p.k.

Neni 3 – Objekti i shoqërisë

- 3.1. Shoqëria ka për objekt ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterilë, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale dhe ambienteve ku do të ofrohet ky shërbim, në spitalet universitare dhe rajonale të vendit, apo dhe spitale të tjerë, sipas planit të racionalizimit spitalor në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të koncesionit/partneritetit publik privat të dhënë nga Ministria e Shëndetësisë sipas njoftimit të Fituesit nr. 1440/13 prot. date 23.06.2015.
- 3.2. Shoqëria mund të kryej çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë sipas nenit 3.1 me lart.

Neni 4 – Selia

- 4.1. Selia e Shoqërisë është në Autostrada Tiranë Durrës, km. 5, Numri i Pasurisë 11/24, zona kadastrale 2679, Mezez) Tiranë, Shqipëri.
- 4.2. Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.
- 4.3. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë.

Neni 5 – Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.
- 5.2. Shoqëria mund të prishet përpara këtij afati ose mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 6 – Kapitali themeltar

- 6.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është Euro 20.000 (njetëmijë).
- 6.2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 4 (kater) kuota, të gjitha të nënshkuara, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar të Shoqërisë përcaktuar në nenin 7 (shtatë) të këtij Statuti.

Neni 7 - Kontributet

- 7.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:
 - Shoqëria Investital ofron një kontribut në para të barabartë me Euro 8.000 (tetëmijë), nëpërmjet depozitimit të kësaj shume pranë llogarisë bankare në emër të shoqërisë në themelimin e sipër;

- Shoqëria Servizi Italia ofron një kontribut në para të barabartë me Euro 6.000 (gjashtëmijë), nëpërmjet depozitimit të kësaj shume pranë llogarisë bankare në emër të shoqërisë në themelimin e sipër;
- Shoqëria Tecnosanimed ofron një kontribut në para të barabartë me Euro 3.000 (tremijë), nëpërmjet depozitimit të kësaj shume pranë llogarisë bankare në emër të shoqërisë në themelimin e sipër;
- Shoqëria Ujet ofron një kontribut në para të barabartë me Euro 3.000 (tremijë), nëpërmjet depozitimit të kësaj shume pranë llogarisë bankare në emër të shoqërisë në themelimin e sipër.

7.2 Sipas kontributeve të mësipërme:

- Shoqërisë Investital, i përket një kuotë, me vlerë nominale Euro 8.000 (tetëmijë), që i korrespondon 40% (dyzetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- Shoqërisë Servizi Italia, i përket një kuotë, me vlerë nominale Euro 6.000 (gjashtëmijë), që i korrespondon 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.
- Shoqërisë Tecnosanimed, i përket një kuotë, me vlerë nominale Euro 3.000 (tremijë), që i korrespondon 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.
- Shoqërisë UJËt, i përket një kuotë, me vlerë nominale Euro 3.000 (tremijë), që i korrespondon 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar

- 8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- 8.2 Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me vlerën nominale të kuotes së kapitalit të zotëruar. Në rast se disa nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me vlerën nominale të kuotes së kapitalit të zotëruar prej tyre.

Neni 9 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Ortakëve. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me vlerën nominale të kuotes së kapitalit të zotëruar prej tyre.

Neni 10 – Transferimi i kuotave

- 10.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 10.2 Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin më të gjerë të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet më parë t'i ofrohen në parablerje ortakëve të tjerë.
- 10.3 Në një rast të tillë ortakë që do të transferojë kuotën e tij duhet të njoftoj ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t'i referohet të gjithë kuotes të ofruar për shitje.

- 10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuota e ofruar nga ortaku që transferon ate, do të ndahet midis ortakëve pranues, në të njëjtën masë me vleren nominale të kuotes së kapitalit që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
- 10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Ortakëve.
- 10.7 Në rast të transferimit të kuotave për shkak trashëgimie *mortis causa* ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj. Në rast se nuk jepet pëlqimi, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Ortakëve me shumice të thjeshte.

KAPITULLI III ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

Neni 11 – Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj


- 11.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.
- 11.2 Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e statutit, emërimi e shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkatës.

Neni 12 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës

- 12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota në proporcion me vleren nominale të kuotes së kapitalit që ai zotëron.
- 12.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 12.3 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

Neni 13 – Thirrja e Asamblesë së Ortakëve, Kuorumi dhe Vendimet

- 13.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 120 (njqindenzjete) diteve kalendarike nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.



- 13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve sidhe prej një ose disa ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje që duhet t'u dërgohet ortakëve – në adresën që rezulton sipas këtij Statuti – dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 13.3 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, veç në Itali ose në Shqipëri.
- 13.4 Në rast se Asambleja e Ortakëve nuk mbledhet me thirjen e parë për mungesën e kuorumit të parashikuar në pikën 13.7 të këtij Statuti, Asambleja e Ortakëve do të thirret brenda 30 (tridhjetë) ditësh me të njëjtin rend dite.
- 13.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të ditës; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.
- 13.6 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.
- 13.7 Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 71% (shtatedhjetenjë përqind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve që kërkojnë një shumicë të cilësuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë të paktën 71% (shtatedhjetenjë përqind) të kapitalit themeltar.
- 13.8 Asambleja e Ortakëve vendos ndryshimet e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, me votën pro të $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e ortakëve të pranishëm që zotërojnë të paktën 71% (shtatedhjetenjë përqind) të kapitalit themeltar. Në të gjitha rastet e tjera, Asambleja e Ortakëve merr vendime me shumicë të thjeshtë votash të ortakëve që zotërojnë më shumë se 71% (shtatedhjetenjë përqind) të kapitalit themeltar.
- 13.9 Çdo Asamble drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.
- 13.10 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari.

Neni 14 – Administrimi

- 14.1 Shoqëria administrohet nga të paktën 1 (një) Administrator i cili do të qëndrojë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje për një periudhë prej 3 (tre) vitesh. Administratori do të emerohet nga Asambleja me votën unanime të të gjithë ortakëve.
- 14.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit. Administratori mund të ushtroj të gjitha kompetencat konform me sa parashikohet në nenin 95 të Ligjit n. 9901 të datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", përveç sa parashikohet në nenin 14.3 në vijim.
- 14.3 Do të jetë i nevojshëm autorizimi paraprak i ortakëve, me vendim që do të merret me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë të paktën 71% (shtatëdhjetenjë përqind) të kapitalit të shoqërisë, për përmbushjen e akteve në vijim:
- Marrja e kredive, garancive dhe çeljen e linjave të kredive në përgjithësi pranë çdo instituti financiar ose ndërmarrje kredie, lidhjen e kontratave me objekt operacione financiare dhe/ose ekonomike, operacione ekonomike dhe/ose financiare të çdo lloji tjetër, blerje apo shërbime, me ose pa garanci, me një vlerë më të madhe se 15.000 (pesmbëdhjetemijë) Euro ose vlerë të njëjtë në monedhë tjetër;
 - Shitblerja, nënshkrimi i kontributeve dhe dhënia me qira e ndërmarrjes ose degëve të ndërmarrjes;
 - Themelimi i shoqërive të çdo tipi, i bashkimit të shoqërive dhe enteve kolektive të çdo tipi;
 - Blerja dhe shitja e pjesëmarrjeve apo interesave të çdo lloji;
 - Blerja, shitja dhe dhënia me qira e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të regjistruara.
- 14.4 Administratorët mund të emërojnë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.


Neni 15 – Eksperti kontabël i autorizuar

- 15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 15.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet në çdo kohë sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 16 - Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 16.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 16.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.



- 16.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga Ligji n. 9901 te dates 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".
- 16.4 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 120 (njeqindnjehzete) diteve që nga fundi i vitit financiar.

Neni 17 – Fitimet

- 17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me vleren nominale te kuotes se kapitalit themeltar të zotëruar.
- 17.2 Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 18 – Prishja

- 18.1 Shoqëria priset me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.
- 18.2 Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

Neni 19 – Likuidimi

- 19.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 19.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
- 19.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do të shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me vleren nominale te kuotes të zotëruar prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 20 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 20.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

20.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 21 – Gjuha

21.1 Ky Statut është hartuar në 7 (shtate) kopje në gjuhën shqipe me shtojcë përkthimin në gjuhën italiane.

21.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti, versioni në italisht do të jetë i vetmi dhe do të jetë ligjërisht detyrues.

ORTAKET


Per Investital LLC



Z. Umbro Staccini

Perfaqesues

Per ~~Servizi~~ Italia S.p.A.



Z. Umbro Staccini

Perfaqesues


Per Tecnosanimed S.r.l.



Z. Umbro Staccini

Perfaqesues



Per Ujet S.r.l.



Z. Giorgio Tradioli

Perfaqesues

PERKTHYESE



**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"SaniService" Sh.p.k.**

Sot më datë 03 Korrik 2015, u paraqiten palet e mëposhtme:

- Investital Llc. ("**Investital**"), shoqëri e së drejtës kosovare, regjistruar pranë Agjencise së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë, me kod fiskal 601138507, me seli në Bedri Shala, nr. 1, Prishtinë, Kosovë, me administrator te vetem Z. Ilir Rrapaj, qytetar shqiptar, lindur në Vlorë, Shqipëri, më 19.04.1972, me leter njoftim nr. 032169553 dhe numer personal H20419098N, perfaqesuar nga Z. Umbro Staccini, qytetar italian, lindur ne Perugia, me 07.04.1952, me banim ne Umbertide (PG), me pasaporte n. YA4124652, ne baze te prokures se posacme nr. 1824 rep. e nr. 525 kol. te leshuar me date 25.06.2015, para noerit Valbona Selimi;
- Servizi Italia S.p.A. ("**Servizi Italia**"), shoqëri e së drejtës italiane, regjistruar pranë Dhomës së Tregtisë Parmë, me numër regjistrimi dhe kod fiskal 08531760158, me seli në Soragna, (PR), Via San Pietro, 59 B Cap 43019, frazione Castellina, Itali, me Kryetar te Keshillit te Administrimit Z. Enea Righi, qytetar italian, lindur në Sala Bolognese (BO), më 19.02.1956, me kartë identiteti nr. AT 8549127, perfaqesuar nga Z. Umbro Staccini, qytetar italian, lindur ne Perugia, me 07.04.1952, me banim ne Umbertide (PG), me pasaporte n. YA4124652, ne baze te prokures se posacme nr. 1824 rep. e nr. 525 kol. te leshuar me date 25.06.2015, para noerit Valbona Selimi;
- Tecnosanimed S.r.l. ("**Tecnosanimed**"), shoqëri e së drejtës italiane, regjistruar pranë Dhomës së Tregtisë Peruxhia, me numër regjistrimi dhe kod fiskal 00660040544, me seli në Umbertide (PG), Via del Commercio, 2 Cap 06019, frazione Pierantonio Zona Industriale, Itali, përfaqësuar nga Z. Umbro Staccini, qytetar italian, lindur në Perugia, më 07.04.1952, me pasaportë nr. YA4124652, sipas vendimit të Këshillit Administrativ të shoqërisë, datë 14.02.2015 të shoqërisë; dhe
- U.Jet S.r.l. ("**Ujet**"), shoqëri e së drejtës italiane, regjistruar pranë Dhomës së Tregtisë Peruxhia, me numër regjistrimi dhe kod fiskal 01388750547, me seli në Bastia Umbra (PG), Via S. Francescuccio de' Mietitori, 32 Cap 06083, Itali, përfaqësuar nga Z. Giorgio Tardioli, qytetar italian, lindur ne Assisi (PG), me 22.05.1953, me letër njoftim nr. AS 9624240, ne baze te procesverbalit te Asamblese se Pergjithshme te shoqërisë date 18.02.2015 rep. 260.237.


Të cilat kanë vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti, së cilës i bashkëngjitet (më poshtë "Shtojca 1").

Neni 1 - Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është "SaniService" Sh.p.k.

Neni 2 - Selia

Selia e Shoqërisë është në Autostrada Tirane - Durres, km. 5, (Numri i Pasurisë 11/24, zona kadastrale 2679, Mezez) Tiranë, Shqipëri.



Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë do të jetë me një afat të pacaktuar.

Neni 4 – Objekti i shoqërisë


- 4.1 Shoqëria ka për objekt ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterilë, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale dhe ambienteve ku do të ofrohet ky shërbim, në spitalet universitare dhe rajonale të vendit, apo dhe spitale të tjerë, sipas planit të racionalizimit spitalor në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të koncesionit/partneritetit publik privat të dhënë nga Ministria e Shëndetësisë sipas njoftimit të Fituesit nr. 1440/13 prot. date 23.06.2015.
- 4.2 Shoqëria mund të kryej çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë sipas nenit 3.1 me lart..

Neni 5 – Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është Euro 20.000 (njetetmije).
- 5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 4 (kater) kuota, të gjitha të nënshkruara, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar të Shoqërisë përcaktuar në nenin 7 (shtate) të këtij Statuti.

Neni 6 - Kontributet

- 6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:
- Shoqëria Investital ofron një kontribut në para të barabartë me Euro 8.000 (tetëmijë), nëpërmjet depozitimit të kësaj shume pranë llogarisë bankare në emër të shoqërisë në themelimin e sipër;
 - Shoqëria Servizi Italia ofron një kontribut në para të barabartë me Euro 6.000 (gjashtëmijë), nëpërmjet depozitimit të kësaj shume pranë llogarisë bankare në emër të shoqërisë në themelimin e sipër;
 - Shoqëria Tecnosanimed ofron një kontribut në para të barabartë me Euro 3.000 (tremijë), nëpërmjet depozitimit të kësaj shume pranë llogarisë bankare në emër të shoqërisë në themelimin e sipër;
 - Shoqëria Ujet ofron një kontribut në para të barabartë me Euro 3.000 (tremijë), nëpërmjet depozitimit të kësaj shume pranë llogarisë bankare në emër të shoqërisë në themelimin e sipër.



6.2 Sipas kontributeve të mësipërme:

- Shoqërisë Investital, i përket nje kuotë, me vlere nominale Euro 8.000 (tetëmijë), që i korrespondon 40% (dyzetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- Shoqërisë Servizi Italia, i përket nje kuotë, me vlere nominale Euro 6.000 (gjashtëmijë), që i korrespondon 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.
- Shoqërisë Tecnosanimed, i përket nje kuotë, me vlere nominale Euro 3.000 (tremijë), që i korrespondon 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.
- Shoqërisë UJet, i përket nje kuotë, me vlere nominale Euro 3.000 (tremijë), që i korrespondon 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 7 – Transferimi i kuotave

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8 – Administrimi


8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administratorë i Shoqërisë personi si më poshtë:

- Z. Bledar Rrokaj, qytetar shqiptar, i biri i Qemalit, lindur më 04.10.1983, në Vlore, me banim në Lagja Lef Sallata, Rr. Aranit Serbi, Vlore, me letër njoftim nr. 030254566 dhe numër personal I31004080U.

8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe nenit 14 të Statutit.

8.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohen për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur.

8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.




Neni 9- Gjuha

- 9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 7 (shtate) kopje në gjuhën shqipe me shtojcë përkthimin në gjuhën italiane.
- 9.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin e akteve si më lartë, versioni në Italisht do të jetë i vetmi version ligjërishit detyrues.

ORTAKET

Per **Investital LLC**


Z. Umbro Staccini
Perfaqesues

Per **Servizi Italia S.p.A.**


Z. Umbro Staccini
Perfaqesues


Per **Tecnosanimed S.r.l.**



Z. Umbro Staccini
Perfaqesues

Per **Ujet S.r.l.**


Z. Giorgio Tradioli
Perfaqesues

PERKTHYESE





**STATUTO
DELLA SOCIETÀ A RESPONSABILITÀ LIMITATA
"SaniService" SH.P.K.**


- Investital Llc. ("**Investital**"), società di diritto kosovaro, iscritta presso l'Agenzia di Registrazione delle Imprese di Kosovo, con codice fiscale 601138507, con sede legale in Bedri Shala n. 1, Pristina, Kosovo, con amministratore unico il Sig. Ilir Rrapaj, cittadino albanese, nato a Valona, Albania, il 19.04.1972, con carta d'identità n. 032169553 e numero personale H20419098N, rappresentato dal sig. Umbro Staccini, cittadino italiano, nato a Perugia, il 07.04.1952, residente a Umbertide (PG), con pasaporto n. YA4124652, in base a procura speciale n. 1824 rep. e n. 525 kol. rilasciata in data 25.06.2015, davanti al notaio Valbona Selimi;
- Servizi Italia S.p.A. ("**Servizi Italia**"), società di diritto italiano, iscritta presso la Camera di Commercio di Parma, con numero di iscrizione e codice fiscale 08531760158, con sede legale in Soragna, (PR), Via San Pietro, 59 B Cap 43019, frazione Castellina, Italia, con presidente del Consiglio di Amministrazione della società Sig. Enea Righi, cittadino italiano, nato a Sala Bolognese (BO), il 19.02.1956, con carta d'identità n. AT 8549127, rappresentato dal sig. Umbro Staccini, cittadino italiano, nato a Perugia, il 07.04.1952, residente a Umbertide (PG), con pasaporto n. YA4124652, in base a procura speciale n. 1721 rep. e n. 494 kol. rilasciata in data 12.06.2015, davanti al notaio Valbona Selimi;
- Tecnosanimed S.r.l. ("**Tecnosanimed**"), società di diritto italiano, iscritta presso la Camera di Commercio di Perugia, con numero di iscrizione e codice fiscale 00660040544, con sede legale in Umbertide (PG), Via del Commercio, 2 Cap 06019, frazione Pierantonio Zona Industriale, Italia, rappresentata dal Sig. Umbro Staccini, cittadino italiano, nato a Perugia, il 07.04.1952, con passaporto n. YA4124652, secondo il verbale del Consiglio di Amministrazione della società del 14.02.2015; e
- U.Jet S.r.l. ("**Ujet**"), società di diritto italiano, iscritta presso la Camera di Commercio di Perugia, con numero di iscrizione e codice fiscale 01388750547, con sede legale in Bastia Umbra (PG), Via S. Francescuccio de' Mietitori, 32 Cap 06083, Italia, rappresentata dal Sig. Giorgio Tardioli, cittadino italiano, nato a Assisi (PG), il 22.05.1953, con carta d'identità n. AS 9624240, secondo il verbale di Assemblea Ordinaria della società del 18.02.2015 repertorio n. 260.237.

Le predette parti hanno deciso di stipulare il seguente Statuto di una società a responsabilità limitata, la cui attività verrà regolata dalla legislazione Albanese in vigore e dallo presente Statuto.

**CAPITOLO I
FORMA, DENOMINAZIONE, OGGETTO, SEDE, DURATA.**

Art. 1 – Forma

- 1.1. La Società "SaniService" Sh.p.k. (d'ora in avanti la "**Società**") è costituita in forma di società a responsabilità limitata, ed è regolata dal presente Statuto.
- 1.2. La Società opera secondo la legislazione albanese in vigore.
- 1.3. Lo Statuto della Società e' conforme alla normativa albanese a carattere inderogabile ed e' integrato, per quanto in essi non espressamente previsto, dalla legislazione albanese.



Art. 2 - Denominazione

La denominazione della Società è "SaniService" Sh.p.k.

Art. 3 – Oggetto sociale

